



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KP.nr. 101/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit “A...” Sh.p.k me seli në fshatin Komuna Lipjan, të cilën e përfaqëson pronari M.M. , kundër të paditurit N.T.P “ B...” me seli Rrugën “... ” në Lipjan të cilin e përfaqëson pronari B.H. , me objekt kontesti pagimi i qirasë, jashtë seance me datën 03.10.2022 merr këtë :

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia –

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit “A...” Sh.p.k me seli në fshatin Komuna Lipjan, të cilën e përfaqëson pronari M.M. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri N.T.P “ B...” me seli Rrugën “... ” në Lipjan të cilin e përfaqëson pronari B.H. , që paditësit ti paguaj shumën prej 2262 E në emër të qirasë së pa paguar dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi më datën 22.04.2016 në Gjykatën Themelore Prishtinë Dega në Lipjan ka ushtruar padi kundër të paditurit N.T.P “B...” me seli Rrugën “... ” në Lipjan të cilin e përfaqëson pronari B.H. , me objekt kontesti Lirimi i lokaleve, dorëzimi në posedim dhe pagimi i qirave të pa paguara.

Gjykata Themelore Prishtinë – Dega Lipjan, duke vepruar sipas padisë ka caktuar seanca dhe pas tyre ka marr Aktgjykim C.nr.174/16 të datës 12.12.2016, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesë padinë e paditësit duke e detyruar të paditurin që paditësit t’ia liroj nga sendet dhe njerëzit si dhe t’ia dorëzoj në posedim lokalin afaristë në sipërfaqe prej 27m2 dhe lokalin tjetër në sipërfaqe prej 60m2, të cilat gjinden në Lipjan në tregun e kafshëve si dhe ti paguaj shumën prej 2.262,00 Euro në emër të qirasë së pa paguar nga data 05.02.2015 deri në ditën e paraqitjes së padisë në Gjykatë. Kundër këtij Aktgjykimi i padituri ka ushtruar ankesë.

Gjykata e Apelit duke vepruar sipas ankesës me Aktgjykimin CA.nr4543/2017 të datës 14.04.2021, pjesërisht e ka aprovuar ankesën e të paditurit ashtu që Aktgjykimin e atakuar e ka vërtetuar sa i përket lirimit të lokalit nga njerëzit dhe sendet si dhe të njëjtit ti dorëzoj paditësit në posedim dhe mbajtje, ndërsa është prishur Aktgjykimi pjesërisht sa i përket pagimit të qirasë së pa paguar dhe lënda është kthyer në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata ka caktuar seancën e datës 29.09.2022, ku prezent ishin palët për paditësin pronari M.M. ndërsa për të paditurën pronari B.H. dhe në këtë seancë paditësi deklaroi se i padituri i ka liruar lokalet dhe i ka dorëzuar në posedim këtu paditësit, duke i propozuar gjykatës që këtë lëndë ta mbyllë, dhe me vullnetin e tij tërhiqet nga padia dhe kërkesë padia, ndaj të paditurit NTP “B...”, sa i përket pagimit të qirasë, si dhe shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar, i padituri është deklaruar se lokalet i ka liruar qysh para 4 viteve dhe nuk e kundërshton deklaratën e paditësit, ndaj të njëjtit nuk ka as një obligim pasi që janë pajtuar në procedurë jashtë gjyqësore, nuk kërkon shpenzimet e procedurës.

Me dispozitën e nenit 149.1, të LPK-së, shprehimisht parashihet *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heq dorë nga një pjesë e kërkesë padisë apo nga e gjithë kërkesëpadia gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykim në bazë të heqjes dorë)”*, ndërsa me pikën 2, të po të njëjtit nen shprehimisht parashihet *“për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës se paditur”*.

Andaj, duke pasur parasysh se paditësi me deklarinimin e tij në këtë gjykatë në seancën e datës 29.09.2022 ka bërë tërheqjen e padisë dhe kërkesës se saj në tërësi sa i përket pagimit të qirasë, gjykata në mbështetje të dispozitës se nenit 149, lidhur me nenin 388, të LPK-së, gjeti se në

rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore që gjykata të bëjë aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, me çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.101/22, datë 03.10.2022

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.